



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 02.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **30.10.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **GRANDELITE L.L.C**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **GRANDELITE L.L.C** e dt. 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 26.10.2023.
2. Korrigjohet Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 26.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, pas korrigjimit, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **GRANDELITE L.L.C** me date 30.10.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Istog"** me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2**. AK-MSh, me datë 02.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27 – Dosja e Tenderit

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 – Pranueshmeria e kandidateve ose tenderuesve

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te Nderuar Autoritete Kontraktuese

Ne si Operator Ekonomik pjesmarres ne Tenderin: Ndertimi i QKMF ne Istog me dt :26.10.2023 kemi pranuar njoftimin e AK lidhur me perzgjedhjen e OE dhe me eliminimin tone , ne letren zyrtare ne kemi pranuar se jemi eliminuar per keto arsye : 1 : OE nuk ka dorzuar deshmitet e kerkuara si ne dosjen e tenderit, per pune te ne vlere 3 milion euro , Ne kemi ofertuar bashkarisht ne DT me kompanite "METEO SH.P.K, ALTIS CONSTRUCTION LTD, SI DHE QUATRO TRADE andaj kerkojme nga ju si AK qe ta rishikoni dhe njehere kete pozicion mbasi qe ne kemi ofruar me shume here me shume se 3 milion pune te ngajshme ,2. Deklarat nen betim te 2A eshte e nenshkruar nga Pronari Valon Ademi, po ashtu edhe deklarata nen betim e 2T eshte paraqitur nga Valon Ademi, mirpo dallon nenshkrim , ne kerkojme nga ju qe te rivlersoni mbasi qe ne nuk kemi as edhe nje informacion se nga ka ardhur ky definicion mbasi qe ne ne oferten tone nuk kemi asgje qe lidhet me 2T dhe 2A.

Ne si OE ju kerkojme qe te rivlersoni dhe nje here piken e Deklaratave si dhe Projektet, mbasi qe besoj ne vlersimin e drejte te juaje.

Dëmet materiale

Shpenzimet per pergatitjen e dokumenteve.

Stresi i punes.

Fitimi i humbur i planifikuar.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Sa i perket pretendimeve tuaja ankimore, i pari ne lidhje me punet e kryera ne vlere 3 milion euro dhe pretendimi i dyte ne lidhje me Deklaratat nen betim..., pajtohemi pretendimet, ne arsyet e cekura ne Letren Standarde per eliminimin tuaj eshte bere gabim teknik nga ana jone si MSh, meqenese keto nuk jane arsyet e cekura ne raportin e vleresimit, por gjate hartimit te Letrave standarde te shumta, nuk eshte verejtur ky leshim dhe arsyet e tjetres oferte gabimisht jane shenuar ne Letren standarde per ju, andaj kjo nuk e atakon oferten tuaj, por eshte gabim teknik te cilin ne do ta korrigjojmë me Njoftimin e ri mbi Vendimin e AK qe do t publikojmë me këtë korrigjim si dhe me ndonjë korrigjim tjetër eventual.

Arsyet e eliminimit tuaj sipas raportit te vleresimit qe eshte i ngarkuar ne e-prokurim jane:

-Nuk e keni ofruar deshminë e kerkuar si në DT ne sistemin elektronik ne E-Prokurim, por keni dorzuar nje dokument blanko (i zi i palexueshem). OE eshte i papergjegjshem ne perputhje me nenin 32.4 te rregullores te prokurimit public I cili nen percakton se: *Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kerkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Çfarëdo dokumenti që duhet të jetë pjesë e ofertës/aplikacionit, ofertuesi duhet t'a ngarkoj dhe dërgoj vetëm nëpërmjet funksionit "dorëzimi i tenderit" dhe jo nëpërmjet ndonjë funksioni tjetër. Koha e ngarkimit mund të dalloj në varësi të shpejtësisë (daljes) se lidhjes së internetit të ofertuesit dhe të ngarkesës së përgjithshme të sistemit. Pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderit sistemi nuk lejon futjen e ndonjë dokumenti shtesë në lidhje me tenderin.*

- Mungojn ISO 14001 per Quatro Trade
- Mungon ISO 45001 per Quatro trade,
- OE Grandelite - i mungojn te gjitha ISO (9001, 14001, 45001)
- OE Altis Construction - I mungojn te gjitha ISO (9001, 14001, 45001)

Kerkesa per ISO eshte tek Pershtatshmeria Profesionale dhe eshte obligative per gjithe partneret e konzerciumit, sipas Rregullores Nr. 001/2022 per Prokurim Publik, ku specifikohet se:

Neni 26

Grup i Operatorëve Ekonomik

26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, **secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.**

- Nuk e keni plotësuar dëshminë rreth stafit teknik, ku ne NJK dhe DT është kërkuar "Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë kontratë për secilin punëtor". Për punëtorët e certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë, i ka ofruar certifikatat në emer të punëdhënësit ATC – COM sh.p.k. ndërsa nuk ka ofruar marrëveshje me punëtorët mbi angazhimin për këtë kontratë, por e ka ofruar një marrëveshje me titull "Marrëveshje për shfrytëzimin e Mjeteve-Makinerve" në mes Grandelite LLC dhe ATC COM shpk, ku është potencuar shkëmbimi i punëtorëve të kësaj kompanie në afat të pacaktuar në rast të shpalljes së fituesit për këtë projekt. D.m.th. e keni ofruar Marrëveshjen me ATC COM shpk por nuk e keni ofruar me punëtorët siç është kërkuar si dëshmi në NJK dhe DT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit